
POSTIM ARKIVOR

Prekë Cali dhe rezistenca e Kelmendit – Shkodër, 1945



SEKSIONI

Kufiri Shkoder

PERIUDHA


1945 - 1945

Në fillim të vitit 1945, në Kelmend, në hapësirën e lidhur me zonën e Shkodrës, ndodhi një përplasje e armatosur ndërmjet forcave Nacionalçlirimtare dhe grupit të drejtuar nga Prekë Cali. Pas përleshjeve, grupi i Prekë Calit u rrethua në shpellën e Vuklit. Rrethimi në shpellën e Vuklit zgjati tetë ditë. Gjatë kësaj kohe, grupi qëndroi i rrethuar dhe nuk u dorëzua menjëherë. Pas tetë ditësh, Prekë Cali vendosi të dorëzohej. Dorëzimi i tij lidhej me kërkesën për garanci dhe me mbrojtjen e të rinjve që ndodheshin me të. Pas dorëzimit, çështja e Prekë Calit kaloi në fazën e arrestimit dhe të akuzave. Më 24 shkurt 1945, Prekë Cali u arrestua. Pas arrestimit, ai u akuzua për veprimtari të armatosur kundër pushtetit të ri. Në kuadër të këtyre akuzave, ai u cilësua si “kriminel lufte” dhe u akuzua për “tradhti ndaj Atdheut”. Këto cilësime dhe akuza u përdorën në procesin që pasoi arrestimin e tij. Bashkë me të u përfshinë në proces edhe persona të tjerë të lidhur me grupin e tij. Këta persona u konsideruan bashkëpunëtorë të Prekë Calit dhe ndaj tyre u dhanë gjithashtu dënime. Procesi përfshiu, përveç Prekë Calit, edhe Ded Lulashin dhe persona të tjerë të lidhur me grupin. Në përfundim të procesit, Prekë Cali dhe Ded Lulashi u dënuan me vdekje. Ndërsa disa prej të pandehurve të tjerë mes tyre Fran Zef Pëllumbi, Fran Dosh Prenga, Ndue Gjo Rapuka dhe Kol Prek Pëllumbi u dënuan me burgim të përjetshëm. Dënimi i Prekë Calit me vdekje u ekzekutua në mars të vitit 1945.

MEDIA #1

Vendimi i 3-marsit 1945

MEDIA FAQE #1



Tue qene gati Prokurori Jonus Mersini dhe Sekretari Shaban Kuçi.

U suall te pandehurit nga burgu dhe u vune ne vendet e posaçme.

U pyet Prokurori,ne se kishte gje tjeter per te shtuar i cili nuk pati gje.

U pyetne te pandehurit ne se kishne gje per te shtuar te cilet thane jo.

Me qene se nuk mbeti tjeter gje per zgjerim te hetimeve Gjyqit ju dha fund dhe u deklarua ky:

V E N D I M

Prenk Cali nga Vermoshi,Gjelosh Toma,Ded Lulash Smaili,Fran Zef Pellumbi,Prel Tom Gjergji,Kol Prek Pellumbi,Tona Tomia,Gjergj Mark Luca nga Katundi Niksh,Fran Mirash Zefi,Fran Dosh Preka,Mark Gjelosh Vata,Pal Mark Gjeka,Dod Nikoll Zefi,Fran Pretash Zogu,Ndue Gjon Rapuka,Dod Fran Doshi,Ndue Luc Gjoni,Ndue Gjek Vuksali,Maç Luc Gjoni,Gjon Mirash Zefi,Nikoll Pretash Zogu,Ded Gjelosh Lula,Mark Gjok Vuksani,Zef Gjon Rapuka,Mark Tom Luca nga katundi Vukle,me akt-akuzen e Prokurorisë Nr.60 date 27.II.1945,jane sjelle per gjykim si te pan- dehur,se Prenk Cali,ne mareveshje me okupatoret ka punuar ne dem te Frontit N.CL.,dhe te pandehurit e tjere me urdherin e tij kane mare pjese aktive ne lufte per rezimin e ketij Fronti.


Ne procedimin gjyqesor,te rrjedhur faqesisht,te pandehurit kane mohuar fajet e tyre dhe kane kerkuar pafajsine.

Gjykata si shqyrtoi aktet,pretendimet dhe mbrojtimet e te pandehurvet e pretencen e Prokurorisë arsyeton:

1) Nga te pandehurit Prenk Cali,si Kryebajraktar'i Kelmendit per t'a forcuar me shume titullin e tij dhe per te shfrytezuar ma mir popullin e pafajshem,ne bashkepunim me Ahmet Zogun ka pasur per qe-

Vendimi i 3-marsit 1945

MEDIA FAQE #2



Faqe 17 152

llim mbajtjen e tyre ne arresire tue mos i mjaftuar ato te 500 vjetve te Qeveris Otomane per keto vegra eshte dekoruar nga Padroni i tij me Titullin Kapiten Kreshnik.

Ma von i pandehuri nga rekomandimet e Ahmet Zogut eshte bere nik i ngushte edhe i Gjeneral Parlemit,i cili prej kohet gunonte ne dem te Shtetit Shqiptar,dhe si vegle e ketij e ndergjegjshme ka pu- nuar kundra shtetsitetit toksor dhe Independences Shqiptare ne menyre qe kjo te behesh Koloni Italiane te cilen e ka realizuar me 7 Prill 1939.

Me qene se i pandehuri edhe mbas pushtimit t'Atdheut ka va- zhduar te qendroje besnik i Gjeneral Parlanit,te zbatoje urdherat e ketij dhe te Dalmacios dhe ato te Qeverive trathetare qysh nga Shef- qet Verllaci deri tek Mehdi Beu,aq sa ka mobilizuar nje pjese te popullit Shqipetar dhe tue e bashkuar me ate te armikut e ka hedhur ne lufte kundra ish Qeveris Jugosllave ne Vjetin 41-42,ngasana tjeter esht ay qe ka mare pjese aktive per formimin e Milicis e te tjera, per t'a hedhur kete ne lufte kundra levizjes N.CL.Shqipetare dhe per merite te ketyre sherbimeve per veç shperblimeve te tiera asht deko- ruar edhe me Titujt: CAVALIERO E RE URDHERIN E SKENDER BEUT.

Me qene se te pandehurit nuk i kane mjaftuar veprat e tija kriminale qe u shenuan me malt por edhe me ardhjen e okupatorit Na- zist eshte rekomanduar prej bashkepuntoreve te tij Mehdi Beut,Fiqri Dines,Hysni Demes prane Gestapos dhe tue e ndruar fytyren e tija nga Fashizmi ne Nazizme si vegle e ndergjegjeshme e ketyre kan vendosur mobilizimin e nje pjese te popullit (Milici,Gjindarmeri,etj.)per te shuar luften e popullit Shqipetar qe behesh kundra okupatorit dhe t'a udhehiqte Ushtrin e ketij te fundit ne operacionet,diegjet,vras- iet,internimet e masakrave te tiera,te cilat edhe jane kryer.


Me qene se i pandehuri ka dashur te organizonte sa me mire popullin e Kelmendit per t'a hedhur ne lufte kundra Frontit N.CL. mbi kerkimin e tij i asht dhane prej Gestapos nje Kompani dhe nje Batalion qetnikesh e mbani jane kryer keto organizime i ka hedhur ne lufte kundra Frontit N.CL. Jugosllav dhe atij Shqiptar.

Me qene se i pandehuri ka qene nje nga bashkepuntoret e ngushte te okupatoreve dhe te Qeverive Kuislinge ka bere qe populli Shqiptar te masakrohet nga gdo pikpamje prej forcave te tij.

Me qene se tek i pandehuri ekziston nje shpirt kriminali- teti dhe tue mos qen i ngopur me veprat e tij te deritashme ka organizuar forcat e Bajrakeve te tij dhe ne mareveshtje me t'arra- tisurit LLesh Marashin me shoke ne muajin Janar te N.V.i ka hedhur

Vendimi i 3-marsit 1945

MEDIA FAQE #3



Faqe 18

ne lufte kundra Ushtris N.CL.me qellim qe te rezonte Pushtetin e sotme te vendosur prej vet popullit.

2) Nga te pandehurit Ded Lulash Smaili tue qen nje nga bashkpuntoret me te ngushte i te pandehurit Prenk Calit ka mare pjese aktive n'organizatat qe pregatiteshin dhe bashke me forcat e komanduara prej Prenk Calit ne musjin Gusht te V.K.jane hedhur ne lufte kundra Ushtris N.CL.Jugosllave dhe nga ky luftim kane mbetur miaft partizane te vrare.

Me qene se i pandehuri Ded,tue respektuar gjithnji urdhnat e patronit te tij nga ana tjeter per t'u njohur edhe si Komandant asht larguar nga Katundi Vet tue ardhur ne Kelmend me qellim qe te bente propagande ne popullin e ketyne katundeve per te pasur nje urejtje ndaj Frontit N.CL. dhe per t'u qene gati ne rast se Kelmendi do te operohej nga forcat partizane,keto forca,te priteshin me lufte,gje e cila edhe esht realizuar.

Gjat operimeve t'Ushtris N.CL.ne rejonet e Kelmendit i pandehuri ka mare pjese aktive ne lufte aq sa edhe ne shpellen ku ndodhesh i rethuar ka leftuar me terbim ku nga ky luftim kan mbetur te vrare dy partizane.


3) Te pandehurit Fran Zef Pellumbi,Fran Dosh Freka,Ndue Gjon Rapuka e Kol Preng Pellumbi i treti edhe si bajraktar perveç qe kane mare pjese aktive nder lufte kundra Ushtris N.CL.me rastin qe operohesh ne ato vende por nga ana tjeter kane ba mbledhje te shpeshta sidomos ne Broje per te shtytun popullin qe te mirte pjese ne kete lufte gje e cila eshte realizuar.

Me qene se te pandehurit si besnike te Patronit te tyre Prenk Calit jane munduar per meshefjen e ketij tue e shpure ne shpellen e Vuklit dhe gjat rrethimit te tyre ne kete shpelle perveç qe kane mare pjese aktive ne lufte por jane ata qe kane penguar doresimin e popullit nder partizane mbasi e kishin helmatisur me parullat e tyre te me pareshme.

4) Te pandehurit Gjelosh Tom Luca,Zef Gjon Rapuka e Ded Gjelosh Lula tue qen te udhehequr prej te pandehurve qe shenohen ne Nr.I,2 e 3 te ketij Vendimi,perveç qe kane mare pjese ne mbledhje te vazhdushme per mbi organizimin dhe menyren e luftimit kundra Frontit N.CL.por kane mare pjese aktive dhe ne luften e Tamares dhe se rezistenca qe kane bere ne shpellen ku ishin te rethuar jane fakte keto qe provohen me deponimet e tyne dredharake të te pandehunve te tjere dhe se ne keto luftime Ded Gjelosh Lula ka mbetur i plagosur.

Vendimi i 3-marsit 1945

MEDIA FAQE #4



Faqe 19

5) Te pandehurit Pal Mark Gjeka,Ded Fran Doshi,Prel Tom Gjergji Ndue Gjok Vuksali,Maç Luc Gjoni e Mark Gjergj Vuksani me gjith qe kane mohuar te marrunit pjese ne mbledhje dhe ne lufte kundra Ushtris Partizane por faji i tyne provohet me deponimet e te pandehurve te tjere qe u kane atribuar njeri-tjetrit,se keta tue u bindun urdhnave te patronve te tyne jane mobilizuar dhe kane mare pjese direkte ne lufte e sidomos ne ate te shpelles ku ishin te rethuar te cilet kane rezistuar deri ne fund.

Me qene se te pandehurit nuk kane qene koshiente te kesaj lufte por u jane bindur urdherave dhe parullave te zhvilluara prej Frenk Calit dhe Ded Smailit keshtu qe nuk meritojne denimin qe mund t'u caktohet ketyre te fundit,por nuk mund te quhen edhe te pa fajshem.

6) Te pandehurit Ded Nikoll Zefi e Fran Pretash Zogu ndonse nuk kan mare pjese ne mbledhje te shpeshta por i jane neneshtruar urdhreve te Frenk Calit dhe jane mobilizuar per t'u hedhur ne lufte dhe nga ana tjeter tue mare parasysh se keta nuk kan qene koshienta per punen e bame veç se kan respektue urdhnat e Padrontit te tyne.

Me gjith qe nuk rezulton miaftesisht e provuar qe te kene mare pjese aktive ne lufte me rastin qe ndodheshin te rethuar por tue mare parasysh deklaratat e te pandehurit Maç Luces etj.nuk len aspak dyshim qe te mos kene leftuar.

7) I pandehuri Gjon Mirash Zefi me gjith qe edhe ky ka mohuar te ket mare pjese aktive ne lufte te zhvilluar si jasht edhe ne shpelle kur ndodheshin te rethuare por tue mare parasysh te tane rrethimin e gjykimit dhe deponimet e te pandehure te tjere nuk len aspak dyshim qe te mos ket luftuar gjat kohes qe ndodheshin te rethuar.


Me qene se i pandehuri nuk ka qene koshient i puneve te bame por asht udhequr prej te pandehureve te tjere e sidomos prupa turmes qe ishte mobilizuar.

8) Sa per te pandehurin Ndue Luc Gjonin me gjith se nuk provohet me asnje menyre qe ky te ket mare pjese ne mbledhjet e bame dhe ne luftime kondra Frontit N.CL.;por me qene se ati i tija ka qene nje nga udheheqesit e turmes popullore per ne lufte kundra frontit nga ana tjeter qdo mbledhje qe behej ne shtepin e tij nuk len aspak dyshim qe te mos ket pasun dijeni nga keto organizata dhe mbledhje qe zhvilloheshin ne rrethet e Kelmendit.

9) Sa per te pandehurit e tjere Fran Mirash Zefi,Tona Tomia, Mark Tom Luca,Gjergj Tom Luca,Mark Gjelosh Vata e Nikoll Pretash Zogu, nuk u provue me asnje menyre qe keta te kene mare pjese aktive ne mbledhje dhe ne lufte kundra partizaneve,nga ana tjeter me rastin e

Vendimi i 3-marsit 1945

MEDIA FAQE #5



Faqe 20

operimit te forcave ne keto vende,nuk u jane gjetur mbi vehte arme dhe disa prej tyre kan shkuar ne shpelle per meshefje mbasi ishin tronditur prej parullave te hapura prej trathetarve dhe nje pjese eshte doresuar vullnetarisht dhe nje pjese tjeter jane gjetur ne shtepiat e veta.

Prandaj Trupi Gjykues tue pelqye pjeserisht kerkimin e Prokurorit Vendosi :1) Fajesin e te pandehurit Prenk Calit si kriminel lufte ne dem t'interesave t'Atdheut.2) Fajesin e te pandehurit Ded Lulash Smailit si pjesemares direkt dhe si organizator ne lufte kundra Frontit N.CL.3) Fajesin e te pandehurve Fran Zef Pellumbit, Fran Dosh Prenga,Ndue Gjon Rapuka e Kol Preng Pellumbit si inisiatore dhe pjesemares direk ne lufte kundra Frontit N.CL..4) Fajesin e te pandehurve Gjelosh Tom Luca,Zef Gjon Rapuka e Ded Gjelosh Lula si pjesemares aktive ne lufte kundra Frontit.5) Fajesin e te pandehurve Pal Mark Gjeka,Ded Fran Doshi,Prel Tom Gjergji,Ndue Gjok Vuksali,Maç Luc Gjoni,Mark Gjek Vuksani si pjesemares direkt ne lufte te udhehequr prej te pandehurve te tjere.6)Fajesin e te pandehurve Dod Nikoll Zefit,Fran Pretash Zogut si pjesemaress ne lufte por jo koshienta.7) Fajesin e te pandehurve Gjon Mirash Zefit e Ndue Luc Gjonit i pari si rezistues ne luften e shpelles dhe i dyti si dijetar i organizimit qe bahesh. 8) Pa fajesin e te pandehurve Fran Mirash Zefit,Tona Tomia,Mark Tom Luca,Gjergj Tom Luca,Mark Gjelosh Vata e Nikoll Pretash Zogu dhe lirimin e tyre nga burgu ne mos qofshin te ndaluem per ndonji tjeter çeshtje.

Mbas njoftimit te ketij Vendimi PROKURORI kerkoj caktimin e denimit te fajtoreve simbas Nenit I te Ligjes Nr.21 date 15.12.1944.

Te pandehurit nje zani kerkuan lehtesimin e denimit.

V E N D I M

N'EMER TE POPULLIT SHQIPETAR

Vepra e fajtoreve i takon Nenit I te Ligjes Nr.21 date 15.12.1944 prandaj u vendos ndeshkimi i tyre si pason:

1) Denimi i fajtoreve Prenk Calit e Ded Lulash Smailit me VDEKJE.


2) Denimi i fajtoreve Fran Zef Pellumbi,Fran Dosh Prenga, Ndue Gjon Rapuka e Kol Preng Pellumbi me BURGIM TE PERJETSHEM.

3) Denimi i fajtoreve Gjelosh Tom Luca,Zef Gjon Rapuka e Ded Gjelosh Lula me nga 30 vjet burgim.

4) Denimin e fajtoreve Pal Mark Gjeka,Ded Fran Doshi,Prel Tom Gjergji,Ndue Gjergj Vuksali,Maç Luc Gjoni e Mark Gjergj Vuksani me nga 20 vjet burgim.

Vendimi i 3-marsit 1945

MEDIA FAQE #6



Faqe 21

5) Denimin e fajtoreve Dod Nikoll Zefi,Fran Pretash Zogut me nga 5 vjet burgim.

6) Denimin e fajtorit Gjon Mirash Zefit me 3 vjet burgim.

7) Denimin e fajtorit Ndue Luc Gjoni me 2 vjet burgim.

Sekuestrimin e krejt pasunise te luajteshme e te palujteshme te te denuemit Prenk Calit.

Ky Vendim i referohet Gjyqit Nalt Ushtarak per shqyrtim.

Shkoder,me 3 Mars 1945

Sekretar . Anetar Anetar Kryetar'i Gjyqit:

Vendimi i 3-marsit 1945

INFORMACION

Vendimi i 3-marsit 1945

FONDI	nr. 1
DOSJE	Hetimore-Gjyqesore
VITI	1945
NR.	287.A


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Aktakuzë, 27 nëntor 1945

MEDIA FAQE #1



PROKURORIA GJYQIT USHTARAK
KOR. ARMATA III
Nr. i prot. 22
Nr. i Akt Akuzes 60.

Shkoder, me 27/II/945

AKT - AKUZE

Gjykates Ushtarake
Korp Armates se III

VASD

Nga akuzat e mesdhenu kunder te pandehunvet Frenk Celit, Gjeloshi Tom Lula, Fran Mirash Zefi, Ded Lulash Gjegji, Fran Desh Prenga, Fran Sef Zalushi, Mark Gjeloshi, Pal Mark Gjoka, Ded Nikoll Zefi, Fran Prendush Zogu, Kolle Gjon Kapuka, Ded Fran Doshi, Prel Tom Gjergji, Kole Frenk Zalushi, Ndue Luc Gjoka, Ndue Gjek Vukshi, Tona e Tom Dalsan, Ded Luc Gjoni, Gjon Mirash Zefi, Nikoll Prendush Zogu, Ded Gjeloshi Lula, Mark Gjon Vuksani, Zef Gjon Kapuka, Mark Tom Bado e Gjergj Tom Luca, i pari nga Vermosh dhe te tjert nga Vukli resulton qarte e provuame se i pandehuni Frenk Ka gene me lidhje te ngushte me okupatort dhe u ka sherbye ne lufte kunder Ushtrise N.Ç. politikisht e ushtarikisht dhe se po i pandehuni ne fjale se bashku me te tjert me daten 20/II/945 kur jane rrethuar ne shpellen e Vuklit nga Ushtria N.Ç. kan realizuar kunder forcave t'ona me armë.

Veprat e te pandehunve jane nga sto qi parashikohen e denohen prej nenit 1 te Ligjes mbi sabotort e luftes.

Prandaj mbasi te provohet faji i tyne kerkojme caktimin e masakimit.

Bjitas parqesim dhe dorazim aktakuze bashkengjitur.

Prokurori:

Aktakuzë, 27 nëntor 1945

INFORMACION

Aktakuzë, 27 nëntor 1945

FONDI	Nr. 1
DOSJE	HHetimore-Gjyqesore
VITI	1945
NR.	287.A

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.